

***PERMBLEDHJE JOTEKNIK E RAPORTIT  
TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS  
PER AKTIVITETIN, "INSTALIM I  
IMPIANTIT TE THYERJES DHE  
FRANKSIONIMIT TE INERTEVE  
PRODHIMIT TE BETONIT DHE  
ASFALTOBETONIT***

**"INDUSTRIA MINERARE"**

**ID 3.1e. Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos, si dhe prodhimi i llaçit, kollës, gëlqeres (parafabrikateve, paletave, etj**

**ID.3.11. Prodhimi dhe fraksionimi i produkteve minerale jometalike.**

**"VEPRIMTARITË E KATRANIT DHE TË BITUMIT"**

**ID.7.3 c "Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b, ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi**

**INVESTITOR : ERAL CONSTRUCTION COMPANY" Shpk**

*Hartoi: Ing. Adhurim Çaushti*

*Ekspert VNM/ Certificate Nr. 5129 Prot. Nr. Identifikues 426*

## **NJOFTIM**

Lenda *Kerkese per zhvilimin e procedures se degjeses me publikun*

**Drejtuar                      Agjencise Kombetare te Mjedisit**

**Tiranë**

Subjekti "Eral Construction Company" eshte regjistruar ne QKBme NPTI:K82230002K date 25/10/2008

Adresa e Zyres qendrore te shoqerise                      **Tirane Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajës,  
Pallati Nr.29, Kulla B, Kati 9, Ap.36**

Administratori: **z Ervin Qendro**

Vendndodhja e objektit ku do te zhvillohet Projekti i propozuar: ***Fshati Palasë Bashkia Vlore***

Subjekti "Eral Construction Compani" sh.p.k eshte duke pergatitur dokumentacionin Ligjore per pajisje me leje Te Tipit "B" per aktivitetie e listuara me siper

Per realizimin e projektit, kompania ne fjale ,ka lidhur kontrate qeraje me Bashkine Himare, me Nr. 1068 Prot, date 31.03.2023, per nje siperfaqe prej 11 640 me per vendosjen e kantierit Siperfaqe ndodhet ne Ekonomine Pyjore" FAJEO" me parcelen nr.1 sipas hartes bashkengjtur e cila eshte prone publike dhe qe administrohet nga bashkia Himare pjese e territorit te se ciles eshte eshte territori i kerkuar per aktivitetin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
**BASHKIA HIMARË**  
DREJTORIA E MENAXHIMIT DHE MBROJTJES SË TOKËS, PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 1068 prot

Himarë, më 31.03 2023

### KONTRATË QIRAJE

#### “PER DHËNIE NË SHFRYTËZIM TË SIPËRFAQEVE PRONË PUBLIKE PYJORE/KULLOSORE”

Referenca Ligjore:

Ligji nr.115/2014, “Për ndarjen territoriale ne Rep.Shqiperise”

Ligji nr.139/2015, “Per veteqeverisjen vendore”

Ligji nr.10304/2010, “Per lejen minerare ne Rep.Shqiperise”,i ndryshuar

Ligji, nr.10431/2011, “Per mbrojtjen e mjedisit”,i ndryshuar,

VKM nr.559, datë 29.07.2022 , “per percaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor .....etj”,

VKM Nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”

Ligjit nr. 48/2016 neni nr.19, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9385, datë 4.5.2005, “për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

Ligjit nr. 49/2016 neni 17 “Për disa ndryshime/shtesa ligjin nr.9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullosor”,

Ligjit Nr.7850 date 29.07.1994 , “ Per Kodin Civil te Republikes se Shqiperise” kreu VI.

Sot me datë 31.03.2023 në Himarë, lidhet kjo kontratë ndërmjet palëve si me poshtë:

1- **Bashkia Himarë:** e përfaqesuar nga Kryetari i Bashkisë **Z. Jorgo GORO** me cilesinë e Autoritetit Kontraktues të sipërfaqes pyjore kullosore, pronë publike e njohur si e tillë sipas ligjit:

2- Subjekti “**ERAL CONSTRUCTION**” Shpk.

3. Lidhet kjo kontrate per dhenie ne perdorim te siperfaqes prej 11.640 m<sup>2</sup> per vendosjen e kantierit si dhe për depozitim te perkohshem materialesh te ndryshme.(si pike tranziti) Siperfaqja prej 11.640 m<sup>2</sup> ndodhet ne Ekonomine Pyjore" FAJEO" ne parcelen nr.1 sipas hartes bashkelidhur kesaj kontrate dhe eshte prone publike qe administrohet nga Bashkia Himare.



Shoqeria "Eral Construction Company" shpk, nofton Agjencine Kombetare te Mjedisit per zhvillimin e procedures se informimit te publikut per **"Pajisje me te lejes mjedisore te tipit B per instalimin:**

**“INDUSTRIA MINERARE”**

*ID 3.1e. Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos, si dhe prodhimi i llaçit, kollës, gëlqeres (parafabrikateve, paletave, etj*

*ID.3.11. Prodhimi dhe fraksionimi i produkteve minerale jometalike.*

**“VEPRIMTARITË E KATRANIT DHE TË BITUMIT”**

*ID.7.3 c “Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b, ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi*

Njoftimi hartohet Referuar VKM nr. 419, date 25.06.2014, "Per miratimin e kerkesave te posaçme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A, B dhe C, per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisi, si dhe te rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e tyre ng QKB-ja te ndryshuar, kreu VI "Informimi dhe pjesemarja e publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit A dhe B" bashkengjitur gjeni dokumentacionin e kerkuar sipas pikes 2 te ketij kreu:

- a) Informacion nese kerkesa do te jete per :Aplikim per leje mjedisi te tipit A ose te tipit B" apo **"Aplikim per leje se mjedisit tipit B"**;
- b) Te dhenat e ekstraktit te QKB-se;
- c) Adresen e vendndodhjes se instalimit ;Fshati Palase, Bashkia Himare, Qarku Vlore
- d) Pershkrimin e veprimtarise qe parashikohet te zhvillohet ne instalim;dhe afatet qe do te ndiqen
- e) Nje pershkrim te elementeve te listuar ne formularin informues;
- f) Permbledhje joteknike te raportit te vleresimit ne mjedis , ne nivel kombetar ose nderkufitar, kur kerkohet procedura e VNM-se;
- g) Konsultimet nderkufitare , kur kerkohet sipas legjislacionit ne fuqi;
- h) Autoritetin vendimmarres per dhenien e akit te miratimit te lejes se mjedisit, procedurat dhe afatet qe do ge ndiqen;
- i) Adresen e AKM-se , ku publiku mund te dergoje komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo ne forme elektornike, brenda 20( njezet) diteve nga data e njoftimit

Subjekti "ERAL CONSTRUCTION COMPANY" shpk  
NIPTI; **NPTI:K82230002K**

Administratori  
Ervin QENDRO

**“ERAL CONSTRUCTION COMPANY shpk**  
**“Permbledhje Joteknike**

Selia Tirane Tirane TIRANE Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga eKavajës, Pallati Nr.29, Kulla B, Kati 9, Ap.36

**Kerkesa mjedisore per objektin**

**“INDUSTRIA MINERARE”**

*ID 3.1e. Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos, si dhe prodhimi i llaçit, kollës, gëlqeres (parafabrikeve, paletave, etj*

*ID.3.11. Prodhimi dhe fraksionimi i produkteve minerale jometalike.*

*ID.7.3 c “Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b, ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi*

**b. TE DHENAT E EKSTRAKTIT TE QKB**

Emri i Kompanisë	<b>ERAL CONSTRUCTION COMPANY</b>
Statusi Ligjor	<b>Sh.p.k</b>
Ortakët/Aksionerët Kompanisë(sipas Ekstraktit të lëshuar nga QKR)	<b>ERVIN QENDRO</b>
Adresa e zyrës qendrore të Kompanisë	Tirane Tirane TIRANE Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajës, Pallati Nr.29, Kulla B, Kati 9, Ap.36
Adresa postale e Kompanisë, nqse ndryshon nga adresa e mësipërme	-----
Numri i rregjistrimit të Kompanisë (NIPT)	<b>NPTI:K82230002K</b>
Përfaqësuesi i autorizuar Emri dhe Mbiemri	<b>ERVIN QENDRO</b>
Telefoni	<b>Cel. 067 205 9967</b>
E-mail	<b>eralconstruction@yahoo.com</b>

**c. ADRESA E VENDNDODHJES SE NSTALIMIT**

Emri i instalimit/impianitit	<b>INDUSTRIA MINERARE</b> <b>ID 3.1e. Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos, si dhe prodhimi i llaçit, kollës, gëlqeres (parafabrikeve, paletave, etj</b>
------------------------------	---

**“ERAL CONSTRUCTION COMPANY shpk**  
**“Permbledhje Joteknike**

	<p><b>ID.3.11.</b> Prodhimi dhe fraksionimi i produkteve minerale jometalike.</p> <p><b>ID.7.3 c</b> “Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b, ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi</p>																																													
Adresa ku ndodhet apo do të ngrihet instalimi/impianti	Fshati Palase, Bashkia Himare, Qarku Vlore																																													
Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGER: 1942_GK_ZONE_4	<table border="1"> <thead> <tr> <th colspan="3">Koordinatat e impiantit GAUSS KRYGER</th> </tr> <tr> <th>Nr.</th> <th>Y</th> <th>X</th> </tr> </thead> <tbody> <tr><td>1</td><td>4380688</td><td>4449993</td></tr> <tr><td>2</td><td>4380712</td><td>4450004</td></tr> <tr><td>3</td><td>4380727</td><td>4449993</td></tr> <tr><td>4</td><td>4380757</td><td>4449986</td></tr> <tr><td>5</td><td>4380783</td><td>4449980</td></tr> <tr><td>6</td><td>4380819</td><td>4450011</td></tr> <tr><td>7</td><td>4380836</td><td>4450007</td></tr> <tr><td>8</td><td>4380840</td><td>4449999</td></tr> <tr><td>9</td><td>4380772</td><td>4449960</td></tr> <tr><td>10</td><td>4380799</td><td>4449860</td></tr> <tr><td>11</td><td>4380799</td><td>4449856</td></tr> <tr><td>12</td><td>4380707</td><td>4449877</td></tr> <tr> <td align="center" colspan="3"><b>Siperfaqja = 11640 m2</b></td> </tr> </tbody> </table>	Koordinatat e impiantit GAUSS KRYGER			Nr.	Y	X	1	4380688	4449993	2	4380712	4450004	3	4380727	4449993	4	4380757	4449986	5	4380783	4449980	6	4380819	4450011	7	4380836	4450007	8	4380840	4449999	9	4380772	4449960	10	4380799	4449860	11	4380799	4449856	12	4380707	4449877	<b>Siperfaqja = 11640 m2</b>		
Koordinatat e impiantit GAUSS KRYGER																																														
Nr.	Y	X																																												
1	4380688	4449993																																												
2	4380712	4450004																																												
3	4380727	4449993																																												
4	4380757	4449986																																												
5	4380783	4449980																																												
6	4380819	4450011																																												
7	4380836	4450007																																												
8	4380840	4449999																																												
9	4380772	4449960																																												
10	4380799	4449860																																												
11	4380799	4449856																																												
12	4380707	4449877																																												
<b>Siperfaqja = 11640 m2</b>																																														
Kategoritë e aktiviteteve/veprimtarive industriale të cilat duhet të kërkojnë leje mjedisi	<p><b>INDUSTRIA MINERARE</b></p> <p><b>ID 3.1e.</b> Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos, si dhe prodhimi i llaçit, kollës, gëlqeres (parafabrikateve, paletave, etj</p> <p><b>ID.3.11.</b> Prodhimi dhe fraksionimi i produkteve minerale jometalike.</p> <p><b>ID.7.3 c</b> “Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b, ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi</p>																																													
Kapaciteti i projektuar	<p><b>Kapacitetet maksimale</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhim inertesh nga impianti 60 m3/dite</li> <li>• Prodhim betoni 60 ton/dite asfalt</li> <li>• Prodhim asfalti deri ne 60 ton/dite</li> </ul>																																													

**d. PERSHKRIMI I VEPRIMTARISE QE PARASHIKOHET TE ZHVILLOHET**

**Qellimi i zhvillimit te projektit**

Veprimtaria qe do zhvilloje ky subjekt, bazuar ne ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit”, I ndryshuar ne ligjin 52/2020, Shtojca 1 eshte:

**Industria minerare**

**ID 3.1e. Përzjerja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzjerjen e çimentos, grumbullimi i betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos, si dhe prodhimi i llaçit, kollës, gëlqeres (parafabrikateve, paletave, etj**

**ID.3.11. Prodhimi dhe fraksionimi i produkteve minerale jometalike.**

**“VEPRIMTARITË E KATRANIT DHE TË BITUMIT”**

**ID.7.3 c “Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b, ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi**

**VEND NDODHJA**

**ADRESA                      Fshati Palasë**  
**SUBJEKTI                    " Eral Construction Kompany" shpk**  
**ADMINISTRATOR      Ervin Qendro**  
**TEL:                            067 205 9967**


Territori mne te cilin subjekti parashikon te ndertoje nyjen e perpunimit te materialeve inerte, prodhimin e betonit dhe asfaltit eshte nje zone me siperfaqe prej 11 640 m2 dhe se per realizimin e projektit, kompania ne fjale ,ka lidhur kontrate qeraje me Bashkine Himare, me Nr. 1068 Prot, date 31.03.2023, per nje siperfaqe prej 11 640 me per vendosjen e kantierit Siperfaqe ndodhet ne Ekonomine Pyjore” FAJEO” me parcelennr.1 sipas hartes bashkengjtur e cila eshte prone publike dhe qe administrohet nga bashkia Himare pjese e territorit te se ciles eshte eshte territori i kerkuar per aktivitetin.

**IDENTIFIKIMI I PASURISE**


- + ZONA KADASTRALE 2863**
- + NR PASURISE 30/260, VOL FQ**
- + INDEKSI I HARTES K-34-136-(116-C)**
- + SHKALLA 1:25 000**
- + ADRESA E PASURISE “ Rrethi Vlore, Q/F Palase**



**“ERAL CONSTRUCTION COMPANY shpk**  
**“Permbledhje Joteknike**








#### e. PERSHKRIMI TEKNIK PROJEKTIT

##### Impianti i thyerjes dhe fraksionimit te gurit

Furnizimi i Impiantit te thyerjes dhe fraksionimit i cili parashikohet te jete pjeserisht Mobil dhe do te vendoset ne siperfaqen e kerkuar do te sigurohet nga subjekte te trete te cilet kane ne aktivitetin e tyre prodhim guri do te depozitohet ne sheshin prane tij per tu trajtuar per ne impiantin t thyerjes dhe fraksionimit te vendosur brenda siperfaqes se zones

Madhesia e copave te gurit , pas plasjes ka dimensione te ndryshem, nga pluhur deri ne copra me dimensione 30x30 cm ose edhe deri ne 50x50 Cm.

Nisur nga kerkesat e tregut rajonal per material inerte te dimensioneve te ndryshem, impianti qe do te vendoset ne objekt, parashikohet te kete kapacitet perpunues orar prej 60 m3 /ore, me iden e pasjes se nje nje koeficienti sigurie pasi kerkesa per material inerte mund te rritet edhe mbi kete nivel prodhimi.



Skema teknologjike e impiantit te fraksionimit

Lenda e pare per linjen e fraksionimit te inerteve sigurohet nga subjekte te trete qe zhvillojne aktivitet per prodhim gure gelqeror. Kjo lende e pare eshte me perberje granulometrike te ndryshme. Zakonisht ka kete perberje

Gur masiv ted ala nga karriera me permasa qe variojne nga 80-100 mm fraksioni 40-60 mm fraksioni 0-25 mm lageshtia 10 % -

Produkt i gatshem

rere e thyer ne masen 15 %

rere e dale nga bluarja 15 %

granil 5-10 mm 25%

granil 10-20 mm 20%

Cakull, tampon e stabilizant 25%

***Sheshi per depozitim te lendes se pare***

Sheshi i ndertimit qe do te perdoret per kete objekt, perfaqeson nje siperfaqje toke te sheshte me nje disnivel te pershtatshem, per instalim linje te tille te fraksionimit. Siperfaqja e zene per kete objekt, nuk eshte toke produktive per bujqesi, e deri tani nuk ka patur interes nga strukturat ligjore per perdorim tjeter. Sheshi ku parashikohet te zhvilloje sipas te dhenave te subjektit eshte pa

konflikt pronesie. Ne kete shesh behet depozitimi i materialeve inerte te siguruar nga shfrytezimi i gurrores Kjo veprimtari do te kryhet me mjetet perkatese te ngarkim- shkarkimit.


**Linja e prodhimit te materialeve te inerte per ndertim perbehet nga keto elemente:**

1. Bunkeri prites i lendes se pare
2. Transportier i pjerret qe sherben per furnizim te linjes, me pajisjet ndihmese
3. Site vibruese me 3 kate dhe kapacitet perpunues 60 m<sup>3</sup>/ore
4. Pajisje tip shnek per transportin e materialit te imet (rere)
5. Bunker i depozimit te produktit te gatshem me vellim 25 m<sup>3</sup>
6. Ulluk per shkarkimin e mbeturines
7. Linja e furnizimit me energji elektrike dhe ajo e furnizmit me uje
8. Mulli me çekiç, per bluarjen e fraksionit te madh te dale pas larjes se fraksionimit 0- />20 mm. Nga sistemi sitave vecohen agregatet me madhesine e kerkuar, konkretisht: granil-2, granil- 1, dhe rere e thyer/perpunuar te cilat i nenshtrohen procesit te larjes dhe transportohen per ne sheshet e tyre nepermjet transportiereve perkatese.





**“ERAL CONSTRUCTION COMPANY shpk  
“Permbledhje Joteknike**



Makineri per prodhim dhe fraksionim inertesh, mobile



*Pamje e sheshit ku mendohet te instalohet impianti i perpunimit*

Impianti do te kete si pjese perberese ,

Bunkerin e pranimit te gurit me zgaren 30x30 cm

Thyesin konik ne dalje te bunkerit

Sita me dimensionet te ndrushme per çakell 33-22 mm,

Mulliri blojesper çakell 22-16 mm per çakell 16-8 mm Grnil, 8-4 mm granil4-0 mm, ne dalje do te kete nje sistem konstruksionesh metalike mbi te cilet shtrihet rrypi i transmisionit per sistemimn ne shesh te nenproduktit

Punonjesit qe do te punesohen do te jene me eksperience ne kryerjen e proceseve te ndrushme te karakterit minerar.

### **Impianti i Prodhimit te Betonit**

#### **Procesi Teknologjik i Prodhimit te Betonit**

Furnizimi dhe mbushja e silloseve te cimentos behet me cemento rifuxho nga boti I cimentos qe sillet nga te trete.

Pasi kontrollohen silloset e cimentos qe te kene sasi cimentoje te mjaftueshme per prodhim betoni dhe pasi mbushen me fadrome vaskat e inerteve me rere, granil 1-sh, granil-2, ndizet impianti I betonit ne pultin e komandimit, I cili eshte me nje panel me ekrane te vegjel me numra qe tregojne sasite e reres, granilit, cimentos, ujit, aditivit sipas formulave per secilen marke apo klase betoni qe kerkojme te prodhojme.

Ne fillim hapen farfallat poshte vaskave te inerteve dhe rera, granil 1, granil 2, shkarkohen ne peshoren e inerteve, nga ku sasia e caktuar e inerteve sipas formules per marken ose klasen e kerkuar, nepermjet transportiereve shkon ne hinken e inerteve ne impiantin e betonit dhe zbret ose ne perzieresin e impiantit te betonit ose ne perzieresin (qypin) e betonieres.

Shtohet sasia e caktuar e ujit (sipas formules se betonit), peshuar me pare nga peshorja e ujit. Shtohet nese duhet aditivi gjithashtu I peshuar nga peshorja e aditivit dhe cemento shkarkohet nga silloset e cimentos nepermjet shnekeve ne peshoren e cimentos ku sasia e caktuar (sipas klases se betonit) kalon po me nje shnek ne hinken e perzieresit te impiantit ose perzieresit (qypit) te betonieres. Ky process perseritet deri sa te plotesohet sasia e betonit te kerkuar.

Llogaritjet e sasise se reres, granilit 1, granilit 2, ujit, aditivit, cimentos behen per 1 m3 beton dhe pastaj llogaritjet per 2, 3...10 m3 sipas kerkeses dhe kapacitetit mbajtes te betoniereve qe perziejne dhe transportojne betonin e prodhuar.

**Kapaciteti i prodhimit te impiantit eshte 60 m3/ore.**




**“ERAL CONSTRUCTION COMPANY shpk  
“Permbledhje Joteknike**

**PRODUCT / INSTALLATION LOCATION:** MRM 60SC COMPACT CONCRETE BATCHING PLANT / ALBANIE

**CLIENT NAME:** ERAL CONTRUCTION

**CONCERNED TO:** M. GRAMOS

**APPROVED BY:** Mr. ALI MERMER / GENERAL MANAGER / +90 532 463 98 46



**CONCRETE CAPACITY PER HOUR:** up to 60 m<sup>3</sup>/ hour ( for concrete class C20 and mixing time 20 second)

**MIXER TYPE:** MRM BRAND 1,0 m<sup>3</sup> SINGLE SHAFT MIXER (1500/1000 L)

**AGREGATE BUNKER CAPACITY:** 44 m<sup>3</sup> (4 x 11 m<sup>3</sup>) / SQUARE TYPE

**TOTAL ENGINE POWER:** 83 Kw (Silos Excluded)

*Impianti I betonit*

## **Impianti I Prodhimit te Asfaltit**

### **Procesi Teknologjik I Prodhimit te Asfaltit**

Ne fillim behet nxejha paraprake e bitumit disa dite perpara prodhimit ne varesi te temperaturave te ambientit. Nxejha behet me kaldane qe perdor lende djegese gaz dhe ben nxejhen e tubave me vaj termik. Tubat me vaj termik kalojne ne depozitat e bitumit nga ku behet nxejha e bitumit.

Pasi te kontrollohen qe te jene mbushur vaskat e inerteve me rere, granil 1-sh, granil 2-sh, granil 3-sh dhe bitumi te kete temperature 150 C, ndizet impianti I asfaltit.

Si fillim hapen ato farfalla te atyre vaskave te inerteve (kryesisht vaskat e granilit 1,2,3) qe kerkon formula e asfaltit qe po prodhohet si: 1. Konglomerat, 2. Binder, 3. Tapet. Pra hapen farfallat poshte vaskave te inerteve dhe rera, granil 1, granil 2 ose granil 3-sh (ne varesi te asfaltit Konglomerat, Binder, Tapet), kalojne nepermjet transportierit ne barabanin ne forme cilindri I cili rrotullohet bashke me inertet brenda dhe ngrohen me ane te nje kaldaje te montuar ne mes te bazes cilindrike te barabanit. Kjo kaldaje punon me solar ose nafte dhe fut flaken me presion brenda, te ndihmuar nga kompresori i ajrit te barabanit dhe ngoh inertet deri ne temperature 150-160 C.

Inertet e ngrohta me ane te elevatorit me kova te vogla kalojne ne sitat nga ku inertet (rera, granilet) fraksionohen sipas specifikimeve teknike (formular e asfaltit) per prodhimin e asfaltit (1. Konglomerat, 2. Binder, 3. Tapet) dhe kalojne ne peshoren e inerteve dhe pasi peshohet sasia e caktuar (formulat e asfaltit) e inerteve per 1 Ton asfalt kalojne ne perzieres dhe bashkohen me sasine e caktuar te bitumit dhe fillerit te percaktuar ne formulat e asfaltit.

Impianti I asfaltit ka dhe dhomen e filtrave. Gjate prodhimit ne dhomen e filtrave nepermjet aspiratorit te fuqishem, thithet filleri nga inertet e barabanit ne kanale llamarine dhe pasi mblidhet nga filtrat, filleri depozitohet me shnek dhe elevator ne sillosin e fillerit. Nga sillosi filleri dergohet me shnek ne peshoren e fillerit dhe sasia e caktuar (formulat) kalon ne perzieres ku bashkohet me inertet dhe bitumin e ngrohte 150-165 C.

Pasi perzihen mire me lopatat ne perzieres rera, granilet, bitumi, fillerit ne masen 1 Ton asfalt (ose Konglomerat, ose Binder, ose Tapet), asfalti shkarkohet ne koven e asfaltit dhe kova nepermjet kavove terhiqet dhe shkarkon asfaltin ne depozitat e perkohshme ne lartesi 3.5-4 m nga ku farfallat poshte depozitave qe komandohen me pistonat me presion ajri e shkarkojne ne kamion, Ky process prodhimi me 1ton perseritet derisa te plotesohet sasia ne ton e asfaltit te kerkuar.

**Kapaciteti i prodhimit te impiantit eshte 60 ton/ore.**



**Impiant prodhimi asfalti**

#### **f-MASAT ZBUTESE TE NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

##### **Masat e pergjithshme te propozuara per zbutjen e ndikimeve negative mjedisore**

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate procesit teknologjik si te pluhurit ne ajer, zhurmave, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore ne territor, faune dhe flore.

##### **➤ Parandalim**

- Perzgjedhja e teknologjise me cikel te mbyllur me pajtueshmeri mjedisore
- Instalimi korrekt i makinave, sipas skemes teknologjike te permiresuar
- Perzgjedhja dhe trajnim i personelit per menyren e perdorimit te teknologjise dhe veprimit
- Siperfaqja e kantierit do te jete vazhdimisht e lagur per shmangien e ngritjes se pluhurit gjate aktivitetit;
- Kontroll i vazhdueshem dhe mirmbajtje e filtrave te kapjes se pluhurit dhe gazeve
- Sigurimi i sistemit te komandimit te pompave, filtrave dhe pastruesve te tjere;
- Zbatim i rigoroz i sigurimit teknik gjate punes dhe nderprerjes se saj

- Vezhgim dhe kolaudim i vazhdueshem i te gjithë teknologjise se projektit: sistem I qarkullimit te produktit, saracineska, tubo, valvola, tapa, guarnicione
- Testimi periodik i teknologjise

➤ **Kontroli**

- Sigurimi i te gjitha pajisje te nevojshme per riparim, pastrim dhe nderhyrje ne rast emergjencash
- Sperkatje e sheshit te punes dhe rrugeve te levizjes se kamioneve ne kantier
- Levizje e ngadalte e automjeteve ne kantier dhe jashte tij
- Mirembajtja e makinerive dhe kamioneve te punes
- Transporti i inerteve me kamion te mbuluar mbulesë me Polietilieni
- Gjeneratori duhet te rrethohet me mur dhe te kete nje vend te vecante

➤ **Nderhyrje**

- Riparim i menjehershëm i difekteve dhe avarive teknologjike
- Aktivizim i menjehershëm i stafit dhe mjeteve ne rast emetimesh dhe derdhesh te pa parashikuara sipas skemes.
- Pastrim i menjehershëm i derdhjeve aksidentale
- Njoftim i menjehershëm i autoriteteve dhe njesive te specializuara ne rast emergjencash (zjarrfikes, autoambulanca)

➤ **Administrim**

- Perdorimi dhe ruajtja me pergjegjesi e te gjithë infrastruktures dhe makinave sipas skemes dhe rregullave teknologjike.

• **Pluhura te shkaktuara gjate fazes se transportit (aerosole)**

- Mjetet e transportit duhet te levizin te mbuluara gjate transportit te ngarkeses
- Mjetet duhet te pastrohen vazhdimisht nga balta para daljes se tyre nga kantieri.

• **Emetim gazesh nga automjetet per transport te lendes se pare**

- Sasia do te jete minimale por duhet te punohet me eficence dhe te ulet koha e mbajtjes ndezur e motoreve te mjeteve.

• **Emetim zhurmash vibracioni dhe aromash**

- Duhet te kontrollohen vazhdimisht pajisjet dhe impiantet per zhurmen e shkaktuar. Edhe per kete ndikim duhet te shkurtohet ne maksimum koha e mbajtjes ndezur te motorave te mjeteve.

• **Menaxhimi i mbetjeve ngurta**

- Administrata dhe punonjesit e kantierit do t'i kushtojne vemendje te vecante edhe ketij aspekti per te parandaluar ndotjen ne mjedis si riperdorim I lendes se pare etj.
- Ne mjediset e kantierit jane vendosur kosha te grumbullimit te mbetjeve te krijuara nga veprimtaria e kantierit.
- Mbetjet urbane shoqeria do t'i dergoje sipas nje marreveshje me njesine administrative te zones ne fjale ne pike grumbullimin e mbetjeve urbane te zones.

### **Menazhimi I shkarkimeve te gazta**

- Per kete shoqeria do te kryej kontrollin periodik te shkarkimeve te mjeteve te transportit qe perdor si dhe te emisioneve te gjeneratorit. Shoqeria ne menyre periodike do te kryej matje te shkarkimeve te gjeneratorit dhe do t’I kontrolloje ato me limitet ne legjislacion dhe pamtrat ne certifikatat e prodhuesit te gjeneratorit.

### **• Programi i monitorimit dhe elementet e tij**

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis. Persa me siper eshte menduar qe te perzgjidhen per tu monitoruar nga laboratore te nenkontraktuar nga vete shoqeria ata elemente qe realisht mund te identifikohen, maten, regjistrohen dhe komunikohen ne organet e administrimit te mjedisit (AKM, etj). Te dhenat cilesore, sipas tabelës do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vet kompania dhe do te dorezohen ne Agjensine Kombetare te Mjedisit sa here ju kerkohet, sipas proceduarve ligjore dhe rregulloreve ne fuqi.

### **BAZA LIGJORE**

- Ligji nr. 10431, date 09.06.2011 ‘Permbrojtjen e mjedisit’, te ndryshuar;
- Ligji nr. 10440, date 07.07.2011 ‘Per vleresimin e ndikimit ne mjedis’, te ndryshuar;
- Ligji nr.10006, date 23.10.2008 “Per mbrojtjen e faunes se eger”
- Ligji nr. 8906, date 6.6.2002“Per zonat e mbrojtura” ndryshuar me ligjin, Nr.9868, date 4.2.2008 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.8906 date 6.6.2002 “Per zonat e mbrojtura”
- Ligi nr.10 253, date 11.3.2010 “Per gjuetine”
- Ligji Nr. 9533, date 15.5.2006 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
- Ligji Nr. 9791, date 23.7.2007 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
- Ligji Nr.15/2012, Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbiminpyjor"
- Ligji Nr. 36/2013, Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
- Ligji Nr. 38/2013 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9693, date 19.03.2007 "Per fondin kullisor te ndryshuar"
- Ligji Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
- Ligji nr. 68/2014 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9587, date 0.7.2006, “Per mbrojtjen e biodiversitetit”, te ndryshuar.
- Ligji nr. 162/2014 "Per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis"
- VKM nr. 686, date 29.07.2015 ‘Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve perzhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit dhe deklarates mjedisore’;
- VKM nr. 247, date 30.04.2014 “Per percaktimin e rregullave,te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore”



- Ligji nr. 10 463, date 22.9. 2011 ”Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”, te ndryshuar;
- VKM nr. 575 date 24.06.2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”
- VKM nr.175, date 19.1.2011 “Per miratimin e strategjise kombetare te menaxhimit te mbetjeve dhe te planit kombetar te menaxhimit te mbetjeve”
- VKM nr. 371, date 11.06.2014 “Per percaktimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe miratimin e dokumentit te dorezimit te mbetjeve te rrezikshme”
- VKM nr. 418, date 25.06.2014 “Per grumbullimin e diferencuar te mbetjeve ne burim”
- VKM nr. 229, date 23. 04. 2014 “Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe te dokumentit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme”
- VKM nr.519, date 30.6.2010 “Parqet Natyror Rajonal”
- Vendim Nr. 22, date 9.1.2008 "Per caktimin e procedurave dhe te kritereteve te administrimit te pyllit komunal"
- Vendim Nr. 1354, date 10.10.2008 "Per rregullat dhe procedurat qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullisor"
- Vendim Nr. 396, date 21.06.2006 "Per kriteret e transferimit dhe te perdorimit te pyjeve nga njesite e qeverisjes vendore"
- VKM nr.897. date 21.2.2011 “Miratimi i Rregullave per Shpalljen e Zonave te Vecanta te Ruajtjes”
- VKM nr. 532, date 05.10.2000 “Per miratimin e studimit “Strategjia dhe Plani i veprimit per biodiversitetin”
- VKM nr. 676, date 20.12.2002 “Per shpalljen zone e mbrojtur te monumenteve te natyres shqiptare”
- VKM nr. 594, date 10.09.2014 "Per miratimin e Strategjise Kombetare per cilesine e ajrit te mjedisit"
- Vendimi Nr. 435, date 12.9.2002 “Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise”
- VKM nr 352, date 29.04.2015. “Per vleresimin e cilesise se ajrit te mjedisit dhe kerkesat per disa ndotes ne lidhje me te

## **6-Perfundime dhe rekomandime**

### **Perfundime**

- Zbatimi i projektit nuk do te kete pasoja negative te mundshme ne mjedisin e zones.
- Procesi teknologjik i prodhimit nuk shoqerohet me shkarkime të lëngta të rrezikshme. Ujerat qe perdoren ne linjen e prodhimit nuk kane teprice sepse dozohen ne sasi te percaktuara.

Sasite minimale shkarkohen vetem pas dekantimit te mases se ngurte ne vasken dekantuese. Keto shkarkime vijne nga larja e mjeteve te transportit, ujera nga sheshet e punes dhe reshjet.

- Aktiviteti nuk perdor lende te rrezikshme per shendetin e punonjesve si dhe te popullsesise perreth zones dhe si rrjedhim nuk ndikon negativisht tek ata.
- Gjatë procesit të ngarkim – shkarkimit te materialit behet pluhur i lehte dhe drejtuesit e shoqerise do te marrin masa per sperkatjen me uje, për pajisjen e punëtoreve dhe manovratorve te mjeteve te renda me mjetet e domosdoshme për mbrojtjen nga pluhuri, si kominoshe pune, kapele mbrojtese, doreza pune, maska për mbrojtjen nga pluhuri.
- Niveli i zhurmave qe vijne nga automjetet dhe pajisjet e tjera jane brenda normave te lejuara. Nuk perbejne problem shqetesues per punonjesit dhe as per banoret e zones perreth qe jane ne nje distance te konsiderueshme.
- Furnizimi me uje do te sigurohet me bot
- Furnizimi me energji elektrike do te sigurohet nga rrjeti ekzistues sipas nje kontrate qe do te neneshkruhet midis subjektit dhe OSHEE qe mbulon zonen duke plotesuar te gjitha kushtet teknike.
- Zona ku do zbatohet projekti nuk njihet si zone e mbrojtuar me vlera arkitektonike dhe kulturore, pra nuk kemi ndryshime apo demtime te saj duke qene se nuk ekziton ne kete territor.
- Per nje pune sa me optimale në impiant zbatohen rregullat e sigurimit teknik dhe punetoret e manovratoret njihen me keto rregulla ne menyre periodike nga drejtuesit teknik te kantierit.

### **Rekomandime**

Duke ditur se gjate proceseve te punes ne linje emetohet në mjedis pluhur i lehte, ka zhurma te makinerive për të rritur sigurinë në punë të punonjësve dhe per te ulur ne maksimum impaktin ne mjedis, duhet të:

- Te behet rregullisht monitorimi i gjendjes teknike te automjeteve.
- Te behet monitorimi periodik i emetimit te zhurmave ne mjedis.
- Te behet monitorimi periodik i emetimit te pluhurit ne ajer.
- Te njihen punonjesit periodikisht me rregullat e sigurimit teknik.
- Te mirembahen kanalet e drenazhimit te ujerave perreth perimetrit te aktivitetit.
- Te menaxhohen mbetjet e ngurta ne bashkepunim me Njesine e Qeverisjes Vendore.
- Te sigurohet furnizim i mire me energji elektrike per te reduktuar ose shmangur oret e punes se gjeneratorit dhe nderprejre te procesit te punes.
- Te perdoret lende djegese e cilesise se pare per gjeneratorin dhe mjetet e transportit.
- Te aplikohet sperkatja me uje e shesheve te pa shtruara per te reduktuar pluhurin.
- Te mos depozitohet lende e pare ne sasi te medha, per te reduktuar demtimin e peizazhit dhe te erozionit te eres dhe te shiut.
- Te kryhet mirembajtja e automjeteve te transportit ne menyre periodike.
- Te vendosen kosha dhe postera sensibilizues per mbajtjen paster te ambjenteve.
- Investitori te respektojte detyrimet e vena ne Lejen Mjedisore qe do te miratohet nga Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM) dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.
- Subjekti te jete ne dijeni te kuadrit ligjor per mjedisin dhe ndryshimeve te tij.

**“ERAL CONSTRUCTION COMPANY shpk**  
**“Permbledhje Joteknike**

- Te kryhet monitorimi i mjedisit sipas ligjeve ne fuqi dhe te dergohet nje relacion shkresor cdo 6 muaj prane Agjencise Kombetare te Mjedisit.
- Te respektohen normat e teknikes se sigurimit ne pune nga punetoret.